



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr 18845 prot.

Shkodër, me 20.09.2024

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin **PËR NJË NDRYSHIM NË V.K.B. NR. 55 DATË 29.12.2023 " PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM PËRFUNDIMTAR 2024-2026 TË BASHKISË SHKODËR" I NDRYSHUAR.**

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,





REPublika e Shqipërisë

Bashkia Shkodër

Nr _____ prot.

Shkodër, me _____.2024

PROJEKT-VENDIMI

Nr. _____, datë _____.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË V.K.B. NR. 55 DATË 29.12.2023 " PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2024-2026 TË BASHKISË SHKODËR" I NDRYSHUAR.

Këshilli i Bashkisë Shkodër, sot me datë ___/___/2024, në mbështetje neni 54 gërma "dh" të ligjit ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar , ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar ; ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar ; ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; ligjit nr. 97/2023 " Për Buxhetin e vitit 2024" ; Nenit 54 të ligjit nr. 10465 datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 475 datë 30.07.2021 " Për bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar" ; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 " Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1 datë 24.01.2024", VKB nr. 29, datë 03.06.2021 "Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale të ngritura për komunitetin rom dhe për miratimin e "Rregullores së administrimit të banesave sociale me qira të ngritura për komunitetin rom në zbatim të projektit "Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri godina, me kontenier 1+1 dhe 2+1). VKB nr.18 datë 20.02.2023 është miratuar lista shtesë për sitemimin edhe 2 të dy familjeve të reja të këtij komuniteti." i ndryshuar; VKB nr 55 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër te ndryshuar sipas materialit të përgatitur nga administrata e bashkisë dhe me propozim të Kryetarit të bashkisë Shkodër,

VENDOSI

1. Miratimin e ndryshimit të buxhetit miratuar me V.K.B. nr. 55 datë 29.12.2023 " Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", te ndryshuar në vlerën 18,704,387 lekë si më poshtë:

| Pakësime viti 2024 | | | | Lekë | |
|--------------------|------------------|---------------------|---|---------------------------|--|
| Nr | Nr Prog | Programi | Aktiviteti/ Emërtimi | Art.602 Shpenzime korente | Institucioni Likuidues |
| 1 | 4520 Kap 5 | Rrjeti rrugor rural | P04520.Q1.O1.A3 Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës (shtesë) A2 "Rikonstruksion Parkimi në Shirokë" (Blerje bazë materiale) | 18,704,387 | Ndermarrja e Sherbimeve Puneve Publike |
| | | Totali | | 18,704,387 | |

| N r | Nr Prog | Programi | Aktiviteti/ Emërtimi | Art.231 Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndruesh të trupëz. | Institucioni Likuidues |
|-----|----------------|---|--|--|--|
| 1 | 10661 Kap 5 | "Strehimi Social" | P10661.Q2.O1.A3 Sistemim territori dhe punime riparimi te objekteve banesa sociale (qendra e romeve) Zbatim | 6,969,000 | Drejtoria e përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike |
| 2 | 4220 Kap 5 | Sherbimet bujqesore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatoreve | P04220.Q2.O1.A1.Trajtimi i qenve të rrugës. (shtese) i trashëguar A. 3 Ndërtimi i strehëzës së re për Qentë A. 3.1 Zbatim A. 3.2 Mbikqyrje A. 3.3 Kolaudim | 11,343,000 355,591 36,796 | Bashkia Shkoder |
| | | Totali | | 18,704,387 | |

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes



KRYETAR

Benet BECI

Zv. Kryetar

Orion Daj...

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar

Drejtoria e përgjithshme Juridike, Burimet Njerëzore dhe Shërbimet Mbështetëse

Denis...

Drejtoria Juridike

B. Depaja

Ndërrmarrja e shërbimeve dhe punëve publike

Altin...

Drejtoria e mirëmbajtjes së infrastrukturës

Fatbardh...

Drejtoria e përgjithshme sociale dhe rinisë

Edlta Shashi Shashi

Drejtoria e shërbimeve sociale, rinisë, strehimit
dhe shëndetit publik

P/ Glori Kacem

Drejtoria e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik

Bekim Mema

Drejtoria e bujqësisë, zhvillimit rural dhe
trajtimit AMTP

Sandra Mema

Sektori I Finances se NSHPP

Suzana Soreci

Drejtoria e përgjithshme e Mirëmbajtjes së
Objekteve Publike

Glora Hudo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE DHE PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME SOCIALE DHE RINISË
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, RINISË, STREHIMIT DHE
SHËNDETIT PUBLIK
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM
EKONOMIK
DREJTORIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE TRAJTIMIT AMTP

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____ 2024

RELACION

PËR NJË NDRYSHIM NË V.K.B. NR. 55 DATË 29.12.2023 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2024-2026 TË BASHKISË SHKODËR, I NDRYSHUAR.

Të nderuar këshilltarë!

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak VKB nr. 55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër“, i ndryshuar, në programin P04520, “Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës (shtesë)”, është miratuar aktiviteti P04520.Q1.O1.A3/A2 “Rikonstruksion Parkimi në Shirokë” (Blerje bazë materiale) me vlerë 20,000,000 lekë

Nga vlerësimi paraprak me këtë fond ishte parashikuar blerja e bazës materiale për ndërtimin e parkimit ndërsa realizimi i punimeve nga Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike me kapacitetet logjistike dhe fuqinë punëtore që disponon.

Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike ka vijuar procedurat për hartimin e projektit dhe preventivave për objektin “Rikonstruksion Parkimi në Shirokë” (Blerje bazë materiale). Pas lirimit të sheshit të parkimit nga mbetjet inerte të dala nga prishjet e objekteve dhe mbetjet e tjera voluminoze nga vlerësimi i specialistëve ka rezultuar që volumet e punës dhe baza materiale e nevojshme ishin më të mëdha se vlerësimi paraprak i bërë në kushtet e terrenit të mbuluar nga këto mjete. Për këtë arsye është vlerësuar e arsyeshme të mos vijohet me procedurat pasi me fondin e parashikuar dhe kapacitetet logjistike dhe fuqinë punëtore që ndërmarrja disponon nuk garantohet një investim cilësor dhe i qëndrueshëm.

Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, për hartimin e një projekti të mirëfilltë për një investim sa më funksional dhe të qëndrueshëm për objektin “Rikonstruksion Parkimi në Shirokë”, dhe më pas do të propozohet që të planifikohet në planet e investimeve të Bashkisë.

Në këto kushte duke e vlerësuar të pamundur që ky objekt të realizohet si investim emergjent brenda vitit 2024, propozojmë që fondet e parashikuara për objektin

“Rikonstrukcion Parkimi në Shirokë” (Blerje bazë materiale) me vlerë 20,000,000 lekë të jenë të lira për t’u përdorur nga bashkia në programe të tjera prioritare të Bashkisë Shkodër, konkretisht

Programet sociale të strehimit janë programe, të cilat kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballeshëm për individët dhe familjet që nuk janë në gjendje ekonomike dhe sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave.

Bashkia Shkodër prej disa vitesh, po zbaton projekte me synim rritjen e fondit të banesave sociale për familjet dhe individët më në nevojë, duke rikonstruktuar dhe vënë në përdorim objekte publike, pronë të Bashkisë Shkodër.

Projekti i strehimit social “Rikonstrukcion i godinave në pronësi të njësisve të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri, godina sociale, me kontenier 1+1 dhe 2+1)”, ka synuar përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit rom për 27 familje rome në Bashkinë Shkodër, miratuar me VKB nr. 29, datë 03.06.2021 “Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale të ngritura për komunitetin rom dhe për miratimin e “Rregullores së administrimit të banesave sociale me qira të ngritura për komunitetin rom në zbatim të projektit “Rikonstrukcion i godinave në pronësi të njësisve të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri godina, me kontenier 1+1 dhe 2+1). Gjithashtu me VKB nr.18 datë 20.02.2023 është miratuar lista shtesë për sitemimin edhe 2 të dy familjeve të reja të këtij komuniteti.

Gjatë monitorimit të vazhdueshëm, rezulton konsumimi dhe dëmtimi nga faktorë të ndryshëm i dyshemesë në këto kontenier, gjë që bën të pamundur jetesën normale në kushte të tilla.

Për shkak të dëmtimeve të konstatuara shikohet e arsyeshme dhe e domosdoshme ndërhyrja emergjente për përmirësimin e jetesës në këto ambiente.

Njësia e qeverisjes Vendore sipas nenit 54 të ligjit nr. 10465 datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 475 datë 30.07.2021 “ Për bashkëpunimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar” i lind detyra të zbatojë kërkesat e këtij ligji në lidhje me kontrollin e kafshëve të shoqërimit.

Në zbatim të detyrave funksionale por edhe për të administruar një situatë që shpesh krijon probleme për publikun, nevojitet trajtimi i kafshëve të rrugës në streheza të pasaçme, duke i larguar kështu dhe nga ambientet publike dhe rreziqet.

Gjatë këtyre viteve në Bashkinë Shkodër, për të përmirësuar situatën është ndërhyrë në trajtimin veterinar të qenve endacake përmes sterilizimit dhe vaksinimit me një program të detajuar prej disa vitesh që nis me kapjen, transportin, sterilizimin, kastrimin, dehelmitizimin, matrikullimin, rregjistrimin si dhe vaksinimin e tyre. Sot Bashkia Shkodër ka një kapacitet për trajtimin bazik të kafshëve të rrugës prej 200 qen. Pavarësisht ndërhyrjeve është vërejtur që numri i qenve endacake është i konsiderueshem, për shkak dhe të braktisjes së tyre në mënyre të papërgjegjshme. Për këtë qëllim është menduar të ndërtohet një strehëz e re dhe e kompletuar përmes së cilës do të bëhet e mundur që të menaxhohet situata e qenve të rrugës duke krijuar kushte dhe standard të përshtatshme jo vetëm për strehimin por edhe për trajtimin veterinar, që është pjesa më e rëndësishme e këtij procesi. Me këtë investim do të ndërtohet klinika e trajtimit veterinarë në të cilën do të jepet shërbim sipas standardeve për trajtimin e qenve. Gjithashtu përveç ndërtimit të klinikës do të

kemi edhe investim për rritjen e kapacitetit për strehimin e 120 qenve. Kjo do të bëjë të mundur që të kemi kapacitet për strehim dhe trajtim periodik.

Vendodhja e kësaj streheze do të jetë në sipërfaqen e ish repartit ushtarak Rrenc, zona kadastrale nr. 3168, numër pasurie 19/2, e cila tashme është pronë e Bashkisë Shkodër, në bazë të VKM nr. 393 datë 19.6.2024 “Për transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Shkodër, të pronës me emërtimin “Agjencia Rrenc” me vendndodhje në Rrenc, Shkodër, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 413 datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit)”, të ndryshuar.

Në programin, “Sherbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatoreve” në aktivitetin P04220.Q2.O1.A1.Trajtimi i qenve të rrugës. (shtese) , n/aktivitetin A. 3 “Ndërtimi i strehëzës së re për qentë “me VKB nr. 13 date 20.7.2023 “Per nje ndryshim ne VKB nr 71 datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër “ te ndryshuar në zërin investime është miratuar një fond prej 13,983,000 lekë për ndërtimin e nje strehëze. Ky fond, bazuar në nevojat dhe ndryshimet e bëra në projektin e ndërtimit të nje strehëze, rezulton i pamjaftueshem për përfundimin e këtij projekti të rëndësishëm për bashkinë Shkodër.

Për sa parashtruar me siper, bazuar ne dispozitat ligjore: të ligjit 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar , ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ; ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar ; ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit nr. 97/2023 “ Për Buxhetin e vitit 2024” ; Nenit 54 të ligjit nr. 10465 datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 475 datë 30.07.2021 “ Për bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar” ; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “ Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1 datë 24.01.2024”, VKB nr. 29, datë 03.06.2021“Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale të ngritura për komunitetin rom dhe për miratimin e “Rregullores së administrimit të banesave sociale me qira të ngritura për komunitetin rom në zbatim të projektit “Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri godina, me kontenier 1+1 dhe 2+1). VKB nr.18 datë 20.02.2023 është miratuar lista shtesë për sitemimin edhe 2 të dy familjeve të reja të këtij komuniteti.” i ndryshuar; VKB nr 55 datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër te ndryshuar, kërkojmë nga ana juaj mundësinë e shqyrtimit dhe miratimit të pakesimit dhe shtesës së fondit si më poshtë detajuar:

Pakësime viti 2024

Lekë

| Nr | Nr Prog | Programi | Aktiviteti/ Emërtimi | Art.602 Shpenzime korente | Institucioni Likuidues |
|----|------------|---------------------|---|---------------------------|--|
| 1 | 4520 Kap 5 | Rrjeti rrugor rural | P04520.Q1.O1.A3 Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës (shtesë) A2 “Rikonstruksion Parkimi në Shirokë” (Blerje bazë materiale) | 18,704,387 | Ndermarrja e Sherbimeve Puneve Publike |
| | | Totali | | 18,704,387 | |

| Nr | Nr Prog | Programi | Aktiviteti/ Emërtimi | Art.231 Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndruesh të trupëz. | Institucioni Likuidues |
|---------------|----------------|---|---|--|--|
| 1 | 10661 Kap 5 | "Strehimi Social" | P10661.Q2.O1.A3 Sistemim territori dhe punime riparimi te objekteve banesa sociale (qendra e romeve) <i>Zbatim</i> | 6,969,000 | Drejtoria e përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike |
| 2 | 4220 Kap 5 | Sherbimet bujqesore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatoreve | P04220.Q2.O1.A1.Trajtimi i qenve të rrugës. (shtese) i trashëguar A. 3 Ndërtimi i strehëzës së re për Qentë A. 3.1 <i>Zbatim</i> A. 3.2 <i>Mbikqyrje</i> A. 3.3 <i>Kolaudim</i> | 11,343,000 355,591 36,796 | Bashkia Shkoder |
| Totali | | | | 18,704,387 | |

Duke ju falenderuar!



KRYETAR

Borç BECI

Ndërrmarrja e shërbimeve dhe punëve publike

[Signature]

Drejtoria e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik

[Signature]

Drejtoria e përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike

[Signature]

Drejtoria e përgjithshme sociale dhe rinisë

[Signature]

Drejtoria e shërbimeve sociale, rinisë, strehimit dhe shëndetit publik

[Signature]

Drejtoria e bujqësisë, zhvillimit rural dhe trajtimit AMTP

[Signature]

| | | | | | | | |
|--|---|--|---|----------|-----------|-------------|----------|
| Nr. 06 | Projekti: P10661.Q2.O1.A3 Sistemim territori dhe punime riparimi te objekteve banesa sociale (qendra e romeve) | Funksioni: 10 Mbrojtja Sociale N/Funksioni: 106 Strehimi Social Llojet e programit: 10661 Strehimi Social | | | | | |
| a) Përshkrimi i shkurtër i projektit: | | | | | | | |
| i. Situata | | | | | | | |
| Strehimi i grupeve sociale në vështirësi është një nga problematikat kryesore në territorin e Bashkisë Shkodër, dhe në mënyrë të veçantë situata social ekonomike e komunitetit romë dhe konkretisht krijimi i kushteve, sa më optimale të banimit mbetet një nga sfidat më të vështira. | | | | | | | |
| Programet sociale të strehimit janë programe, të cilat kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për individët dhe familjet që nuk janë në gjendje ekonomike dhe sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave. | | | | | | | |
| Bashkia Shkodër prej disa vitesh, po zbaton projekte me synim rritjen e fondit të banesave sociale për familjet dhe individët më në nevojë, duke rikonstruktuar dhe vënë në përdorim objekte publike, pronë të Bashkisë Shkodër. | | | | | | | |
| Projekti i strehimit social "Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësisë të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri, godina sociale, me kontener 1+1 dhe 2+1)", ka synuar përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit rom për 27 familje rome në Bashkinë Shkodër, miratuar me VKB nr. 29, datë 03.06.2021 "Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale të ngritura për komunitetin rom dhe për miratimin e "Rregullores së administrimit të banesave sociale me qira të ngritura për komunitetin rom në zbatim të projektit "Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësisë të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri godina, me kontener 1+1 dhe 2+1)". Gjithashtu me VKB nr 18 datë 20.02.2023 është miratuar lista shtesë për shtetimin edhe 2 të dy familjeve të reja të këtij komuniteti. | | | | | | | |
| Gjatë monitorimit të vazhdueshëm, rezultoi konsumimi dhe dëmtimi nga faktore të ndryshëm i dyshemesë në këto kontener, gjë që ben të pamundur jetesën normale në kushte të tilla. | | | | | | | |
| Për shkak të dëmtimeve të konstatuara shikohet e arsyeshme dhe e domosdoshme ndërhyrja emergjente për përmirësimin e jetesës në këto ambiente | | | | | | | |
| ii. Synimi i projektit | | | | | | | |
| <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i kushteve të strehimit • Bashkërendim dhe koordinim të afërt me qeverinë qendrore për zbatimin e projekteve të strehimit Social | | | | | | | |
| iii. Aktivitetet kryesore të projektit | | | | | | | |
| <ul style="list-style-type: none"> • Ndërhyrje emergjente për shtrimin e dyshemesë • Ofrimi i alternativave për një strehim të përballueshëm e të përshtatshëm | | | | | | | |
| b) Rezultatet që prisni | | | | | | | |
| <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësim i kushteve të strehimit ndaj komunitetit rom dhe egjiptian • Përmirësim i cilësisë së jetes për këtë komunitet. | | | | | | | |
| c) Aktorët e mundshëm | | | d) Kontributet e mundshme në projekt | | | | |
| Individë dhe familje në pozita të pafavorizuara, në vështirësi social-ekonomike që nuk kanë të ardhura të sigurojnë strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm. | | | Bashkia Shkodër Qeveria Shqiptare Ministria e Ekonomisë, Inovacionit dhe Kulturës Donatorë vendas e të huaj, OJF. | | | | |
| e) Shpenzimet e llogaritura në lek | | | | | | | |
| Shpenzimet për çdo aktivitet | | Totali | Nga kjo: | | | | |
| A.1 Sistemim territori dhe punime riparimi te objekteve banesa sociale (qendra e romeve)- zbatim | | 6,969,000 | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| Shuma | | 6,969,000 | | | | | 6,969 |
| Kohëzgjatja 2 muaj nga fillimi i punimeve | | Stafi i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik. Institucioni likujdues Drejtorja e përgjithshme e Mirëmbajtjes së objekteve publike | | | | | |

| | | | | | | |
|--|---|---|----------|---|-----------|-------------|
| Nr. ____ | P04220.Q2.O1.A1 Trajtimi i qenve të rrugës (Shitesh) - e trashëguar | Funksioni 4: Çështje ekonomike NN/Funksion 042: Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia Programi 04220 Shërbimet bujqesore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatoreve | | | | |
| a) Përshkrim i shkurtër i projektit: | | | | | | |
| i. Situata | | | | | | |
| <p>Njësia e qeverisjes Vendore sipas nenit 54 të ligjit nr. 10465 datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë". VKM nr. 475 datë 30.07.2021 "Për bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar" i lind detyra të zbatojë kërkesat e këtij ligji në lidhje me kontrollin e kafshëve të shoqërimin.</p> <p>Gjatë këtyre viteve në Bashkinë Shkodër, për të përmirësuar situatën është ndërhyrë në trajtimin veterinar të qenve endacake përmes sterilizimit dhe vaksinimit me një program të detajuar prej disa vitesh që nis me kapjen, transportin, sterilizimin, kastrimin, dehelmitizimin, matrikullimin, regjistrimin si dhe vaksinimin e tyre. Sot Bashkia Shkodër ka një kapacitet për trajtimin bazik të kafshëve të rrugës prej 200 qen. Pavarësisht ndërhyrjeve është vërejtur që numri i qenve endacake është i konsiderueshem, për shkak dhe të braktisjes së tyre në mënyre të papërgjegjshme. Për këtë qëllim është menduar të ndërtohet një strehëz e re dhe e kompletuar përmes së cilës do të bëhet e mundur që të menaxhohet situata e qenve të rrugës duke krijuar kushte dhe standard të përshtatshme jo vetëm për strehimin por edhe për trajtimin veterinar, që është pjesa më e rëndësishme e këtij procesi. Me këtë investim do të ndërtohet klinika e trajtimit veterinarë në të cilën do të jepet shërbim sipas standardeve për trajtimin e qenve. Gjithashtu përveç ndërtimit të klinikës do të kemi edhe investim për rritjen e kapacitetit për strehimin e 120 qenve. Kjo do të bëjë të mundur që të kemi kapacitet për strehim dhe trajtim periodik të një numri mbi 500 qen.</p> | | | | | | |
| ii. Synimi i projektit | | | | | | |
| Trajtimi veterinar kafshëve të rrugës sipas ligjit nr. 10465 datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë" | | | | | | |
| iii. Aktivitetet kryesore të projektit | | | | | | |
| <ol style="list-style-type: none"> 1. Ndërtimi i strehëzës së re për qentë 2. Procedurat e tenderimit të zbatimit të projektit; 3. Mbikqyrje 4. Kolaudimi 5. Kapja transporti trajtimi veterinar në strehëz | | | | | | |
| b) Rezultatet që prisni | | | | | | |
| 1) Reduktimi i numrit të qenve që qarkullojnë në qytet duke trajtuar dhe strehuar në strehëz | | | | | | |
| c) Aktorët e mundshëm | | | | d) Kontributet e mundshme në projekt | | |
| Drejtoria e përgjithshme e Zhvillimit të qëndrueshëm Ekonomik – Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe trajtimit AMTP | | | | Bashkia Shkodër | | |
| e) Shpenzimet e llogaritura në Lek | | | | | | |
| Shpenzimet për çdo aktivitet | | Totali | Nga kjo: | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime |
| A.3.1 | Ndërtimi i strehëzës së re për qentë | 11.343.000 | | | | 11.343.000 |
| A.3.2 | Supervizim/mbikqyrje e zbatimit të projektit | 355.591 | | | | 355.591 |



| | | | | | | | |
|-------------------------------------|----------|---|--|--|--|--|------------|
| A.3.3 | Kolaudim | 36,796 | | | | | 36,796 |
| | Shuma | 11,735,387 | | | | | 11,735,387 |
| D) Periudha e zbatimit 2024-2025 | | g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e përgjithshme e Zhvillimit të qëndrueshëm Ekonomik Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe trajtimit AMTP Institucioni likujdues: BashkiaShkodër | | | | | |

